

## ANEKS C. UDHËZIME PËR T’U PAJISUR ME NUMRIN DUNS

### UDHËZIME PËR T’U PAJISUR ME NUMRIN DUNS


Të gjithë aplikantët duhet të regjistrohen për Sistemin Universal të Numërimit të të Dhënave (DUNS). Informatën se si ta merrni numri DUNS mund ta gjeni në: <https://fedgov.dnb.com/webform/index.jsp>.

#### PROCEDURA PËR MARRJEN E NUMRIT DUNS ËSHTË E PËRPMLEDHUR MË POSHTË:


1. Kyçuni në D&B (Dun & Bradstreet), të cilën mund ta gjeni në ueb-faqen e DUNS për të filluar me procedurën e marrjes së numrit DUNS, pa pagesë: <http://fedgov.dnb.com/webform/index.jsp>

Ju lutemi vëreni një shirit në të djathtë për Pyetjet e Shpeshta, gjithashtu mund t’i gjeni email adresat dhe numrat e telefonit të Duns & Bradstreet në mënyrë që t’i kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje apo vështirësi në plotësimin e aplikacionit online. D+ nuk është e autorizuar ta plotësojë aplikacionin në emër të organizatës suaj, të dhënat e kërkuara duhet të futen nga një person i autorizuar i organizatës suaj.

2. Përzgjidhni vendin ku organizata/entiteti juaj ka vendndodhje fizike.
3. Fillimisht do t’ju kërkohet për të hulumtuar në databazën e DUNS për të parë nëse organizata/entiteti juaj tashmë ka një numër të tillë ekzistues. Nënkontraktorët/përfituesit e granteve të cilëve ju figuron se kanë numër DUNS mund të verifikojnë/azhurnojnë të dhëna të reja të DUNS.
4. Organizatat/entitetet që nuk kanë numër të DUNS do t’u shfaqet ekrani si më poshtë. Në këtë rast, kërkoni për një numër të DUNS, duke klikuar në butonin “Request a New D-U-N-S Number”.



5. Futni të dhëna që kanë të bëjnë me organizatën/entitetin tuaj si në tre ilustrimet e paraqitura më poshtë. Sigurohuni që i keni këto të dhëna (në anglisht) para se të hyni në këtë seksion në mënyrë që të keni regjistrim të suksesshëm.
- Emri i biznesit (presjet lejohen, pikat nuk lejohen)
  - Adresa
  - Numri i telefonit
  - Emri i pronarit/drejtorit ekzekutiv
  - Numri total i punonjësve
  - Të dalat dhe të hyrat vjetore (në ekuivalent të US \$)
  - Përshkrimi i veprimtarisë
6. Shënim: disa nga fushat janë opsionale, sidoqoftë për të vazhduar me procedurën e regjistrimit duhet të plotësohen të gjitha fushat tjera. Për shembull, të gjithë aplikantët duhet ta plotësojnë seksionin për të dhënat që kanë të bëjnë me organizatën. Pjesa e emrit të kompanisë dhe adresës gjenden automatikisht pas futjes së të dhënave gjatë kërkimit fillestar në DUNS. Nëse klikoni te pjesa e shenjave të pikësimit, që gjenden në të majtë mund të gjeni informata shtesë.



7. Selektoni strukturën ligjore të organizatës suaj nga lart-poshtë. Për t'ju ndihmuar në përzgjedhjen e një strukture adekuate që përfaqëson më së miri organizatën tuaj, më poshtë mund të gjeni një përshkrim të shkurtër nga disa prej tyre:
- **Bashkëpunimi** – Një firmë që plotëson disa kërkesa ligjore për t'u regjistruar nga shteti / provinca në të cilën e ka selinë. Po ashtu, një korporatë e cila konsiderohet ligjërisht si entitet i veçantë dhe i ndarë nga pronarët e saj. Mund të tatimohet; të paditet dhe mund të lidhë marrëdhënie kontraktuale.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

- **Qeveria** – qendrore, provinca/shteti, distrikti, komuna apo entitete tjera lokale të ShBA-së. Këtu përfshihen edhe universitetet, shkollat dhe qendrat profesionale që janë në pronësi dhe udhëhiqen nga qeveria.
- **Shoqatë me përgjegjësi të kufizuar (ShPK)** – Është një lloj i pronësisë së biznesit që kombinon disa tipare të korporatave dhe strukturave të partneritetit. Është krijuar për të siguruar tiparet e përgjegjësive së kufizuar të një korporate dhe efikasitetin e taksave dhe fleksibilitetin operacional të një partneriteti. Pronarët e saj kanë përgjegjësi të kufizuar për borxhet dhe detyrimet e ShPK-së, që është e ngjashme me statusin e aksionarëve të një korporate. Nëse firma juaj është ShPK, kjo e dhënë do të shënohet në dokumentet e regjistrimit dhe licencimit të organizatës.
- **Jo-përfituese** – Një entitet që është krijuar për arsye humanitare dhe që nuk është e destinuar për qëllim përfitim. Çdo e hyrë duhet të shfrytëzohet për shpenzimet, veprimtarinë dhe programet e saja. Shumica e organizatave që janë të regjistruara në vendin pritës si organizata joqeveritare (OJQ) e jo si biznese komercial konsiderohen si subjekte jofitimprurëse.


**Organizatave me bazë në komunitete, shoqatat tregtare, këshillat e zhvillimit të komunitetit dhe subjekte të ngjashme që nuk janë fitimprurëse, duhet ta përzgjedhin këtë status, edhe nëse organizata juaj nuk është regjistruar zyrtarisht si OJQ.**

- **Partneriteti**- është formë ligjore e ushtrimit të veprimtarisë ku dy apo më shumë individë kujdesen për funksionimin e një biznesi fitimprurës si bashkëpronarë. Fitimet dhe humbjet janë të ndara në mënyrë proporcionale.
  - **Pronësia**-këto firma janë në pronësi të një individi, zakonisht të atij që ka obligime ditore dhe drejton biznesin. Tregtarët që hyjnë vetë në biznes i zotërojnë të gjitha pasuritë dhe i marrin të gjitha fitimet që gjenerohen nga këto biznese.
8. Një nga pjesët më të rëndësishme që duhet të plotësohet është kodi SIC (shih ilustrimin më poshtë). Kodi fillestar Industrial Standard i klasifikon bizneset sipas rëndësisë në industri dhe sipas funksionit.

Done



9. Nëse jeni të pasigurt se nën cilin kod SIC është organizata juaj, ju lutemi referojuni kësaj ueb-faqeje:  
<http://www.osha.gov/oshstats/sicscr.html>



Do ju nevojitet të përdorni disa fjalë kyçe për ta marrë kodin SIC. Në ilustrimin e paraqitur më lart, te fjalët kyçe është vendosur fjala “research”, ndërsa rezultatin e kësaj procedure mund ta shihni në ilustrimin në vijim:



JU LUTEMI VINI RE: Shumë nga nënkontraktorët dhe përfituesit e granteve nga D+ ju takojnë këtyre SIC kodeve:

8742 Shërbime të konsulencës dhe menaxhment



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA


1542 Kontraktorët e përgjithshëm – Ndërtesa jo-rezidenciale, përveç ndërtesave industriale dhe depove ose një prej kodeve brenda:

Sektori i industrisë 357: Kompjuterë dhe pajisje për zyrës

Sektori i industrisë 355: Makineri speciale të industrisë, përveç përpunimit të metaleve

Sektori i industrisë 356: Makineri të përgjithshme industriale dhe pajisje

Sektori i industrisë 359: Të ndryshme industriale dhe tregtare



10. Përshkrimi i veprimtarive: Fusni një përshkrim të shkurtër të shërbimeve primare që ofroni sipas shembullit më poshtë, “asistencë teknike bujqësore”, ku është përzgjedhur si veprimtari e parë e biznesit.

The screenshot shows the CCR Webform for a 'New Duns Number Request'. The form is filled out with the following information:

- Country: AFGHANISTAN
- Mailing Address (optional):
  - Street/P.O. Box: [Empty]
  - City: [Empty]
  - State: [Empty]
  - Zip Code + 4-Postal Code: [Empty]
  - Country: Select one
- Organization Information:
  - Executive Name: Mohammad Ali
  - Title: Owner
  - Primary SIC code: [Empty]
  - Description of Operations: Agricultural Technical Assistance
  - Socioeconomic Data: No special Ownership Status
  - Number of Employees (includes owners, partners, and/or officers): 10
  - Annual Sales or Revenue: USD 500,000
- Parent Organization (optional):
  - Name: [Empty]
  - Street: [Empty]
  - City: [Empty]
  - State: [Empty]
  - Zip Code + 4-Postal Code: [Empty]
  - Country: Select one
- Notes (optional): [Empty]

Submit Your Request



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

11. Të dalat dhe hyrat vjetore duhet të paraqiten në ekuivalentin e dollarit amerikan (USD).
12. Pasi të plotësohen të gjitha fushat, klikoni “Submit Your Request” për ta pranuar letrën e verifikimit.
13. Shënim: Përfaqësuesi (Kryesuesi, Pronari ose Zyrtari) duhet të verifikojë dhe sigurojë pohimin në lidhje me saktësinë e të dhënave nën dënimet penale ose civile siç përcaktohet në Titullin 18, Seksioni 1001 i Kodit Penal të Sh.B.A.
14. Pasi të klikoni në butonin “Yes, continue”, aplikimi për regjistrim dërgohet te D&B, ku numri DUNS është i vlefshëm për përdorim brenda 24-48 orëve. Databaza e DUNS mund të vizitohet brenda këtyre orëve (24-48) përmes futjes së të dhënave të biznesit në dritaren e kërkimit – në të cilën duhet të shfaqet numri i ri DUNS që identifikon entitetin.

CCR Webform - verification page - Windows Internet Explorer provided by DAI  
http://fedgov.dnb.com/webform/NewDunsRequest.do

D&B DUNS Numbers™  
for US Government  
Contractors & Grantees

DUNS Number Request > Search > Enter Your Company Information > Verify Information Page >

**Verification Page**

Company Name

Legal Name:

Phone Number of Business:

Physical Address

Street:

City:

State:

Zip Code + 4Postal Code:

Country:

Organization Information

Executive Name:

You affirm that you are a principal, owner or officer of the entity for which you are submitting proposed information and/or changes and that you are properly authorized to submit these changes. You also agree not to knowingly provide any false or misleading information to D&B. Knowingly providing false or misleading information may result in criminal or civil penalties as per [Title 18, Section 1001 of the US Criminal Code](#), and may negatively impact the status of the D&B report maintained on this company.

This also includes the use of a Shelf Corporation. D&B defines a Shelf Corporation as one that exhibits either of the following characteristics: (1) An aged corporation where no prior business activities could be confirmed or (2) An aged corporation that was revoked, dissolved or went to a dormant status, and is subsequently reinstated and is under new control. It is D&B's policy that the historical business activity of a Shelf Corporation, if any, will not be factored into the determination of such Shelf Corporation's start date. As such, any individual who attempts to misrepresent the start date of their business through the use of a Shelf Corporation or any other means is immediately put on information alert status or higher-risk status. In addition, the criminal penalties mentioned above may apply.